



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1026/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Wurth-Kosovo” SH.P.K, me NRB: 70161635, me seli në rr. “Magjistranja Prishtinë - Ferizaj”, km 15, kundër debitorit “NV Company” SH.P.K., me NUI: 810086878, me seli në rr. Josip Rela, Nr. 18/4, në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.98/23 të datës 17.05.2023, të Përmbartuesit Privat Driton Govorri me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 31.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit ““NV Company” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.98/23 të datës 17.05.2023, të Përmbartuesit Privat Driton Govorri

- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.98/23 i datës 17.05.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Driton Govorri.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Wurth-Kosova” SH.P.K, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.98/23 të datës 17.05.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. FDP22-004224,të datës 30.06.2022; Faturës Nr. FDP23-001731 të datës 24.03.2023; Faturës Nr. FDP23-000398 të datës 27.01.2023, me të cilën është detyruar debitori që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 7,595.74 €, me kamatë ligjore siç e parasheh LMD, si dhe t’i paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij urdhri, në të kundërtën përmbartuesi privat do ta bëjë përmbushjen e ekzekutimit me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në

llogarinë e përmbaruesit privat, si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, duke shtuar ndër të tjera se i njëjti asnjëherë nuk i ka pranuar produktet dhe shërbimet e kreditorit për faturën Nr. FDP22-004224. Më tutje ka theksuar se r faturën Nr. FDP22-004224 të datës 30.06.2023 nuk e ka pranuar dhe e njëjta nuk është vulosur nga debitori, ndërsa dy faturat tjera janë të pranuar nga ana e debitorit, meqenëse të njëjtat janë të nënshkruara dhe janë të vulosura. Ka deklaruar se kartela financiare e kreditorit është në mospërputhje me faturat e bashkëngjitura në propozim. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri për përmbartim, si dhe të detyrohet kreditori që t'i paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të cekura në prapësim duke theksuar që qëllimi i të njëjtit është vetëm zvarritja e kësaj procedure përmbartimore. Më tutje ka shtuar se përmbartimi është ushtruar mbi bazën e dokumentit të besueshëm përkatësisht faturave të cilat debitori i ka pranuar dhe i ka nënshkruar dhe si të tilla kanë tiparet e përmbarueshmërisë. Në lidhje me këto fatura ka deklaruar se debitori i ka pranuar duke qenë se janë nënshkruar nga personi i njëjtë, si dhe nuk janë kontestuar asnjëherë. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit si dhe të detyrohet që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr. FDP22-004224, të datës 30.06.2022; Faturën Nr. FDP23-001731 të datës 23.04.2023 dhe Faturën Nr. FDP23-000398 të datës 27.01.2023, i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, si dhe mbajnë vulën dhe nënshkrimin e pranimit nga debitori dhe të njëjtat janë bërë të arritshme për pagesë.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1026/23, datë 31.10.2023

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.